



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E SHËRBIMIT DHE KUJDESIT SOCIAL

PROJEKT VENDIM

Nr. 12854 . datë 21 / 07 / 2025

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR PËR BARAZI, PËRFSHIRJE DHE PJESËMARRJE
TË ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE 2025-2030”**

Në mbështetje të nenit 113 pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 8 pika 2, neni 29 pika 1, Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji Nr. 10/2012 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" garanton të drejta të barabarta dhe mbrojtje nga çdo formë diskriminimi në të gjitha fushat e jetës. Gjithashtu, Ligji Nr. 96/2017 "Për pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë" njohu komunitetet rom dhe egjiptian si pakica kombëtare, duke u garantuar atyre të drejtën për të ruajtur kulturën, gjuhën dhe traditat. Shqipëria është angazhuar gjithashtu përmes Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të Këshillit të Evropës, e ratifikuar në vitin 2000, dhe është pjesë e Deklaratës së Poznanit (2019) në kuadër të Procesit të Berlinit, ku janë përcaktuar objektiva të qarta për integrimin e romëve në Ballkanin Perëndimor.

PROPOZJ:

1. Miratimin e Planit Vendor për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2025-2030”
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” të ndryshuar.

KRYETARI
Pjerin NDREU

NË MUNGESË DHE ME URDHER

ZV.KRYETARE
Brikena VUKSANI

